



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I FIZIKËS BËRTHAMORE TË ZBATUAR

NJOFTIM

Sot më datë 14.02.2022 ora 11:00, në ambjentet e IFBZ u mbledh Komisioni *ad-hoc*, i miratuar nga Drejtori i IFBZ, me Vendim nr. 3, datë 11.02.2022, për të zhvilluar konkursin për 1 (Një) vend të lirë pune për personel ndihmësakademik me karakter mësimor, në Departamentin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetet e Monitorimit, në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar të Universitetit të Tiranës. Konkursi është shpallur në Buletinin nr. 08, datë 24 Janar 2022, të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këtë konkurs, kishte paraqitur dokumentacion 1 (Një) kandidat Z. Ersid OXHAKU për vendin e lirë të punës për personel ndihmësakademik, me karakter mësimor, “Laborant”, në fushën e kontrollit dhe monitorimit të ndotjeve radioaktive të mallrave të ndryshme të import-eksportit nëpër vendkalimet kufitare, në Departamentin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetet e Monitorimit, pranë Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

Komisioni mori në shqyrtim dosjen personale të kandidatit dhe nga shqyrtimi i dosjes, rezultoi se kandidati plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme, si dhe pjesën më të madhe të kriterëve të veçanta, të shpallura në Buletinin nr. 08, datë 24 Janar 2022, në APP.

Kandidati Z. Ersid OXHAKU kishte paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Njoftimin për vend të lirë pune në APP. Nga vlerësimi i këtij dokumentacioni, nga ana e pjesëtarëve të Komisionit, dhe intervistës së kryer në datë 14.02.2022 ora 11:00, në ambjentet e IFBZ, Komisioni vendosi unanimitisht t’i propozojë Rektorit, Z. Ersid OXHAKU si kandidat fitues për vendin e lirë të punës, për personel ndihmësakademik me karakter mësimor, “Laborant”, në fushën e kontrollit dhe monitorimit të ndotjeve radioaktive të mallrave të ndryshme të import-eksportit nëpër vendkalimet kufitare, në Departamentin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetet e Monitorimit, pranë Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar të Universitetit të Tiranës

I gjithë dokumnetacioni do t’i përcillet Rektorit, në cilësinë e punëdhënësit, për vendimarrje.

KRYETARI I KOMISIONIT

Dr. Dritan PRIFTI